



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 13, dt. 11.12.2018

MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2019

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936, dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2019”, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e buxhetit të vitit 2019, Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 12 dt. 11.12.2018 “Mbi miratimin e dokumentit përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 për Këshillin e Qarkut”, VKM nr. 864 dt. 23.07.2010 “Për pajisjen me numur celular të personave juridike, publike”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

1. Të miratoje Planin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2019 si më poshtë:

<i>Të ardhurat e Këshillit të Qarkut</i>	<i>gjithsej</i>	<i>105.5 milion lekë</i>
Nga kjo	- Transferta e pakushtëzuar	52.6 milion lekë
	- Të ardhurat vendore	52.9 milion lekë
<i>Shpenzimet e Këshillit të Qarkut</i>	<i>gjithsej</i>	<i>105.5 milion lekë</i>
Nga kjo	Funksionet e veta	
	- Për administratën e Këshillit të Qarkut	36.8 milion lekë
	- Për shpërblimin e antarëve të Kryesisë të Këshillit të Qarkut	1.0 milion lekë
	- Për investime në Këshillin e Qarkut	21.0 milion lekë
	- Kontribut bashkëfinancim në Proj. BE	41.0 milion lekë
	- Projekti STEP	0.2 milion lekë
	- Projekti “Qendra ditore të moshës së tretë” në bashkëpunim me Bashkinë Korçë	3.0 milion leke
	- Për shoqatën e të verbërve	0.5 milion lekë
	- Shërbimi i kujdesit paliativ Korçë	0.4 milion lekë
	- Qendra Rezidenciale e Zhvillimit Korçë	0.1 milion leke
	- Për fond rezerve	1.5 milion lekë

2. Të miratoje nivelin e tarifave të shërbimeve që ofron Këshilli i Qarkut për komunitetin në funksion të realizimit të detyrave të tij mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi sipas pasqyrës bashkangjitur.
3. Të miratoje limitin e përdorimit të karburantit për automjetet e Këshillit të Qarkut deri në 1000 litra në muaj, por brenda fondit limit për blerje karburanti të miratuar për vitin 2019.
4. Të miratojë limitin e përdorimit telefonisë celulare për vitin 2019 brenda mases 2% të shpenzimeve për mallra dhe shërbime si më poshtë:
 - Kryetar i Këshillit të Qarkut limiti mujor 10000 lekë
5. Të miratoje pasqyrat e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2019, të cilat i bashkangjiten këtij vendimi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik dhe shërbimeve në Këshillin e Qarkut, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit Korçë.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 01 janar 2019.

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI

Konceptoi L.Pleqi
Juristi Gj. Kristo
Sek.K.Qarkut B.Muço



KESHILLI I QARKUT KORÇE


BUXHETI I PERGJITHSHEM I KESHILLIT TE QARKUT PER VITIN 2019

ne 000/ leke

TE ARDHURA			SHPENZIME		
Nr.	Burimet e Financimit	Plani 2019	Nr.	Funksionet	Plani 2019
1	<i>Transfertat</i>	52551	1	Funksionet e veta	
	Transferta e pakushtëzuar	52551		<i>a. Administrata e Këshillit të Qarkut</i>	36801
				Paga Administrata	17200
				Sigurime shoqërore e shëndetsore	3000
2	<i>Të ardhurat</i>	52959		Shpen. operative, vendime gjyqësore	16601
	Kont.financiar bashki viti 2019	6000		<i>b. Shpërblim per Kryesine e K.Qarkut</i>	1000
	Të ardhurat e veta	1800		Për antarët e Kryesisë Këshillit Qarkut	1000
	Të ardhura të trashëguara 2018	45000		<i>c. Investimet</i>	21000
	Të ardhura trash.Proj.STEP	159		Administrata e Këshillit të Qarkut	21000
			2	Programe të tjera	45209
				- Bashkëfinancimi në Projektet e BE	41000
				- Projekti STEP	159
				- Shoqata e të verbërve	500
				- Projekti "Qendra ditore te moshes trete"	3000
				- Shërbimi I kujdesit paliativ Korçe	400
				- Qendra Rezidenciale e Zhvillimit Korçe	150
			3	Fond rezervë	1500
	TOTALI TË ARDHURA	105510		TOTALI SHPENZIME	105510

Kryetar i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI



KESHILLI I QARKUT KORCE


Drejtoria e Finances, Zhvillimit Ekonomik e Sherbimeve

TABELA E TARIFAVE TE SHERBIMEVE PUBLIKE TE KESHILLIT TE QARKUT
PER VITIN 2019

Nr.	Emertimi i taksave e tarifave	Njesi	Tarifa
I	Sektori i Urbanistikës		
1	Dhënie vertetim për efekt strehimi	leke	100
2	Dhënie vertetim për njohje pronësie për gjykatë, komision pronash	leke	300
3	Konfirmim kontratë blerje truall	leke	1500
4	Vertetim për vendimarrje në KRRT etj.	leke	100
5	Vertetim për dokumenta nga arkivi i urbanistikës	leke	500
6	Marje fotokopje projektësh nga arkivi i urbanistikës format A4	leke	200
7	Marje fotokopje projektësh nga arkivi i urbanistikës format A3	leke	400
8	Marje fotokopje skica nga arkivi hartografik i urbanistikës format A4	leke	1000
9	Marje fotokopje skica nga arkivi hartografik i urbanistikës format A3	leke	1500
10	Dhënie leje shfrytëzimi për banesë	leke	5000
11	Dhënie leje shfrytëzimi për lokal, dyqan, magazinë grumbullimi	leke	10000
12	Dhënie leje shfrytëzimi për lokal dhe banesë	leke	10000
13	Dhënie leje shfrytëzimi për hotel (motel)	leke	15000
14	Dhënie leje shfrytëzimi për stacion karburanti (leng dhe gaz)	leke	15000
15	Dhënie leje shfrytëzimi për linjë reparat prodhimi	leke	20000
16	Miratim studim urbanistik pjesor	leke / m2	10
II	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark		
1	Tarife për vertetim për token për jashtë shtetit (Ambasada, konsullata, shtetas shqiptarë me banim jashtë shtetit	leke	500
2	Vertetim toke për leje transporti, licenca ushtrim profesioni	leke	500

Ana VERUSHI

Kryetar i Keshillit të Qarkut



KESHILLI I QARKUT KORCE

Drejtoria e Finances, Zhvillimit Ekonomik e Sherbimeve

TABELA E LLOGARITJE TE TE ARDHURAVE TE KESHILLIT TE QARKUT


VITI 2019

	Emertimi I taksave e tarifave	Njesi	Cmimi	Nr. Njesi	Te ardhura
	Sektori i Urbanistikës				
I	Ligji nr. 10073 dt. 09,02,2009 "Per nje shtese ne ligjin nr. 9632 dt. 30,10,2006				
	Per sistemin e taksave vendore tendryshuar"				
1	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	0,1 % vl.preventiv		1	10000
II	Vendim Keshilli Qarkut nr,84 29,06,2007 nr. 17 dt.30.08.2014 dhe nr. 58 dt. 30.12.2015				
1	Dhenie vertetim per efekt strehimi	leke	100	10	1000
2	Dhenie vertetim per njohje pronesie per gjykate, komision pronash	leke	300	10	3000
3	konfirmim kontrate blerje trualli	leke	1500	4	6000
4	vertetim per vendimarrje ne KRRT etj.	leke	100	5	500
5	Vertetim per dokumenta nga arkivi I urbanistikës	leke	500	5	2500
6	Marje fotokopje projektesh nga arkivi I urbanistikës	leke	200	5	1000
7	Marje fotokopje skica nga arkivi hartografik I urbanistikës	leke	1000	5	5000
8	Dhenie leje shfrytezimi per banese	leke	5000	1	5000
9	Dhenie leje shfrytezimi per lokal, dyqan, magazine grumbullimi	leke	10000	1	10000
10	Dhenie leje shfrytezimi per lokal dhe banese	leke	10000	1	10000
11	Dhenie leje shfrytezimi per hotel (motel)	leke	15000	1	15000
12	Dhenie leje shfrytezimi per stacion karburanti (leng dhe gaz)	leke	15000	1	15000
13	Dhenie leje shfrytezimi per linje repart prodhimi	leke	20000	1	20000
14	Miratim studim urbanistik pjesor	leke / m2	10	0	0
	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes se Tokes ne qark				
I	Urdher nr. 183 dt. 26,05,2011 "Per tarifat e sherbimeve qe kryhen nag Drej.				
	Administrimit dhe Mbrojtjes se Tokes ne qark				
1	Vertetim pronesie para vitit 1946	leke	1000	250	250000
2	Vertetim pronesie pas vitit 1946	leke	1000	250	250000
3	Vertetim negativ para reformes per ne gjykate	leke	500	14	7000
4	Vertetim pronesie per Agjensine e Kthimit dhe Kompesimit te Pronave	leke	500	30	15000
5	Vertetim pronesie qe kerkohet per statusin te pastrehe	leke	200	20	4000
6	Konfirmim I vertetimeve per ndihme ekonomike e perkrahje sociale te ardhura nga komuna / bashki	leke	100	4500	450000
7	Harta e skica planimetrike kadastrale	leke	1000	180	180000
8	Vertetime per kategorizimin e tokes, sipas bonitetit	leke	1000	190	190000
9	Vertetim me te dhena nga formulari nr. 6	leke	500	100	50000
II	Vendim I Keshillit te Qarkut nr. 237 dt. 20,03,2011				
1	Tarife per vertetim per token per jashte shtetit (Ambasada, konsullata, shtetas shqiptare me banim jashte shtetit	leke	500	300	150000
2	Vertetim toke per leje transporti, licensa ushtrim profesioni	leke	500	300	150000

III	Udhezimi I Ministrimit te Financave per zbatimin e buxhetit dhe Vendimi I K.Qarkut				
1	Kontributi financiar Bashkive per vitin 2019				6000000
3	Te ardhura te trasheguara nga 2018				45000000
4	Te ardhura te trasheguara nga 2013 nga Projekti STEP				159500
IV	Transfertat				
1	Transferta e pakushtezuar				52551000
	Totali I te ardhurave				105510500

Ana VERUSHI

Kryetar I Keshillit te Qarkut



KESHILLI I QARKUT
Drejtoria e Finances, Zhvillimit Ekonomik e Sherbimeve

TABELA E LLOGARITJES SE SHPENZIMEVE PER VITIN 2019

ne 000/leke

Nr.	Emeritimi shpenzimit	Nr. punonjes	F. Paga	Sigurim	Total paga sig. shog	Shpen.op. vend gjyqi	Keshilltare	Investime	Projekti fond BE	Projekti STEP (dit)	Qendra dit moshe trete	Shoqata verber	Sherbimi pallativ	Qendra Rezidencial	Fond rezerve	Buxheti total
	Plan buxheti viti 2019															
a	Administrata K.Qarkut	13	16700	3000	19700	10280	925	6065	41000	0	3000	500	400	150	1500	83520
b	Detyrime trashguara		500		500	6321	75	14935		159						21990
	TOTAL BUXHETI	13	17200	3000	20200	16601	1000	21000	41000	159	3000	500	400	150	1500	105510
	Ne % ndaj totalit		16.30	2.84	19.15	15.73	0.95	19.90	38.86	0.15	2.84	0.47	0.38	0.14	1.42	

Liljana Pleqi

Drejtoresh e Finances





REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KORÇE
Drejtoria e Finances, Zhvillimit Ekonomik dhe Sherbimeve

RELACION

MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TE KESHILLIT TE QARKUT PER VITIN 2019

Ne mbeshetje te Ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vndore", Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", Ligjit nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", Ligjit "Per buxhetin e vitit 2019", Vendimit te Keshillit te Qarkut nr. 09 date 21.09.2018 "Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2019-2021 per Keshillin e Qarkut te rishikuar", si dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore, administrata e Keshillit te Qarkut ka punuar per hartimin e shifrave te buxhetit per vitin 2019.

Per hartimin e buxhetit jemi mbeshetur ne:

- Programi buxhetor afatmesem 2019-2021 te miratuar nga Keshilli I Qarkut.
- Raportin per monitorimin e zbatimit te buxhetit te vitit 2018 per periudhen 8/mujore, paraqitur Keshillit te Qarkut ne mbledhjen e muajit Shtator 2018.
- Analiza financiare e realizimit te priteshem te treguesve ekonomike per vitin 2018.
- Mundesite reale te realizimit te burimeve te te ardhurave, si kusht per financimin e shpenzimeve.
- Programi i aktiviteve per vitin 2019 per institucionin e Keshillit te Qarkut te lidhura keto me objektivat e zhvillimit te qeverisjes qendrore.
- Normativat e lejuara te shpenzimeve te miratuara keto me akte ligjore dhe nenligjore.

Se pari po bejme nje analize te shkurter te realizimit te buxhetit per vitin 2018.
Zbatimi I buxhetit per vitin 2018 ka ecur ne kushte normale , kjo si rezultat I nje planifikimi te mbeshetur mbi burime reale te te ardhurave te vete institucionit. Per vitin 2018 pervec aktiviteve dhe programeve te planifikuara per kete vit, institucioni trashgoi edhe 4.8 milion leke borxhe. Ne zbatim te udhezimit per procedurat e hartimit te PBA eshte bere saktesimi I stokut te borxhit ne 31 Tetor 2018 duke ju bashkangjitur edhe detyrimet ne zbatim te vendimeve gjyqesore te formes se prere per punonjes te larguar nga puna ne institucionin e Keshillit te Qarkut dhe ne ndermarjet e rrugeve rurale, si dhe vendime te trasheguara nga ish Keshilli i Rrethit. Me vendim te keshillit te qarkut per miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2019-2021, eshte llogaritur amortizimi I borxhit brenda 3 viteve te PBA. Keto ndryshime jane pasqyruar edhe ne buxhetin e vitit 2019.

• Realizimi I shpenzimeve

Realizimi I pritshem I shpenzimeve te buxhetit per vitin 2018 do te jete 43.5 milion leke, ose 56 %, nga e cila 5.2 milion leke eshte financimi i deficit te trasheguar nga viti 2015 dhe 38.3 milion jane shpenzimet faktike vetem per vitin 2016.

Me poshte po analizojme realizimin e shpenzimeve te planifikuara vetem per vitin 2018.

Realizimi i pritshem i shpenzimeve per vitin 2018

Shpenzime	Plani 2018	I pritshmi 2018	Ne 000/leke	
			Realizim ne %	% ndaj totalit
-Paga administrata/ndermarje	16790	14247	84.86	27.74
-Sigurime administrate/ndermarje	3160	2618	82.86	5.09
-Shp.operative+vend. gjyqesore	17287	14896	86.17	27.7
-Shp.keshilltare	1000	1000	100	2
-Investime	17307	14934	86.29	29
-Projekti me B.Korce "Qendra ditore per moshen e trete"	2000	2000	100	3.9
-Shoqata verberve	870	786	90.35	1.5
-Sherbimi I Kujdesit Paliativ	400	400	100	0.8
-Qendra Rezidenciale Zhvillimit	150	150	100	0.3
-Fondi rezerve	1350	250	18.52	0.5
-Bashkefinancim Projekti BE	40904	69	0.17	0.15
-Projekti STEP	159	159	100	0.3
Total 2018	101377	51509	50.81	100

Fondi I pagave dhe sigurimeve shoqerore ze nje peshe te konsiderushme ne buxhetin e vitit 2018 me rreth 16.8 milion leke ose 32.7% te totalit te shpenzimeve. Numuri I punonjesve te administrates se keshillit te qarkut per vitin 2018 eshte 10 punonjes + tre titullaret e zgjedhur, kjo sipas Ligjit te buxhetit per vitin 2018. Brenda ketij fondi jane financuar te gjitha pagat e administrates se keshillit te qarkut, si dhe paga per punonjes te larguar te institucionit dhe kalimi I tyre ne liste pritje per efekt te zbatimit te vendimit te gjykates te forms se prere. Gjate vitit ka vazhduar rregullisht pagesa e sigurimeve shoqerore. Gjate ketij viti nuk u krijua asnje detyrim I ri na paga e sigurimet shoqerore. Shpenzimet operative te financuara per vitin 2018 ariten ne 14.9 milion leke ose 27.7% te totalit te shpenzimeve. Ne kete ze jane futur shpenzimet per financimin e aktivitetit te institucionit dhe nje pjese e borxhit te trasheguar, financimi I disa vendimeve gjyqesore te trasheguara si dhe detyrime te lindura gjate ketij viti ne zbatim te vendimeve te gjykatave te forms se prere.

Gjate vitit 2018 programi I investimeve eshte realizuar me 14.9 milion leke ose 29 % te totalit te shpenzimeve. Jane realizuar procedurat e prokurimeve per te gjitha objektet ne bashkite sipas miratimit ne Keshillin e Qarkut dhe ka filluar zbatimimi I tyre. Financimi I investimeve do te behet ne fillim te vitit 2019 me perfundimin e kontratave te punimeve dhe marjes ne dorezim te tyre.

Ne zbatim te rregjistrimit te prokurimeve te fondeve publike, te gjitha shpenzimet e prokuruarra dhe te realizuara gjate vitit 2018 jane financuar duke mos krijuar asnje borxh te ri.

Gjithashtu gjate vitit 2018 jane financuar fonde per te trete sipas miratimeve ne buxhetin e Keshillin e Qarkut:

- Pjesemarije ne Projektin me Bashkine Korce "Qendra ditore te moshes se trete" me 2 milion leke
- Shoqatat e te verberve te rajonit me 786 mije leke, nga te cilat 500 mije leke jane kontribute te miratuara per vitin 2018 dhe 286 mije leke jane diferenca kontributi per vitin 2017.
- Sherbimi I Kujdesit Paliativ Korce me 400 mije leke
- Qendra Rezidenciale e Zhvillimit Korce me 150 mije leke

Keto jane zerat kryesore te shpenzimeve te buxhetit per vitin 2016.

• **Realizimi I te ardhurave**

Per vitin 2018 burimet e te ardhurave ne buxhetin e Keshillit te Qarkut kane qene:

Ne 000/leke

Te ardhurat	Plani 2018	I pritshmi 2018	Realizim ne %	% ndaj totalit
Transferta e pakushtezuar	49490	49490	100	45.38
Kontributi financiar I bashkive viti 2018	6000	700	11.67	0.65
Te ardhura nga taksat e tarifat e sherbimeve	1800	1200	67	1.1
Te ardhurat e trasheguara viti 2017	57368	57368	100	52.6
Te ardhurat e trasheguara nga Proj.STEP	159	159	100	0.15
Total 2018	114817	109076		100

Transferta e pakushtezuar vazhdon te jete burimi kryesor i te ardhurave dhe eshte perdorur per financimin e funksioneve te veta te miratuara me Vendim te Keshillit te Qarkut ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi.

Vazhdon te mbetet problem realizimi I kontributit financiar te bashkive per llogari te Keshillit te Qarkut. Theksojme se ky kontribut eshte burimi kryesor I te ardhurave te vete institucionit dhe ze nje peshe te konsiderueshme ne buxhet. Megjithese ky eshte nje detyrim ligjor, nga ana e bashkive vazhdon te mos behet derdhja sipas realizimit dhe % te miratuar ne buxhetin e sejciles bashki. Deri tani kontributi I derdhur nga ana e bashkive eshte si me poshte:

- Bashkia Korce 600000 leke
- Bashkia Maliq 100000 leke
- Bashkia Pogradec 0
- Bashkia Bilisht 0

- Bashkia Erseke	0
- Bashkia Pustec	0
Totali	700000 leke

Pra nga 6 milion leke te planifikuara jane derdhur vetem 700 mije leke nga 2 bashki, nga bashkia Korce dhe Pogradec. Megjithë perpjekjet tona nga ana e Bashkive nuk eshte mare me seriozitet ky detyrim per ta shlyer ate ne nivelin e miratuar nga vete keshillat bashkiake.

Derdhja e ketij kontributi financiar te Bashkive per vitin 2019 duhet te shihet me prioritet nga te gjitha keshillat bashkiake ne procesin e miratimit te buxhetit te tyre per vitin 2019 dhe ne vazhdim per derdhjen e kontributit, pasi eshte nje detyrim ligjor.

Te ardhurat e tjera nga tarifat e sherbimeve qe ofron institucioni si nga kadastra, urbanistika per periudhen 2018 jane realizuar ne vlere 1200 mije lek nga 1800 mije leke te planifikuara. Kjo ndodh pasi edhe planifikimi I tyre behet vetem mbi parashikime dhe jo mbi llogaritje konkrete per vete natyren e ketyre te ardhurave.

Keto ishin disa nga momentet kryesore gjate zbatimit te buxhetit per vitin 2018

- **Hartimi I buxhetit per vitin 2019**

Hartimi i buxhetit per vitin 2019 eshte bere ne mbeshtetje te Ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vndore", Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", Ligjit nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", Ligjit "Per buxhetin e vitit 2019", Vendimit te Keshillit te Qarkut nr. 09 date 21.09.2018 "Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2019-2021 per Keshillin e Qarkut te rishikuar", si dhe akteve te tjera ligjore.

Gjithashtu hartimi i buxhetit per vitin 2019 eshte pare ngushte lidhur edhe me problematikat e trajtuara me lart. **Planifikimi i cdo ze te buxhetit eshte bere per te qene sa me eficient dhe i realizueshem, me qellim qe gjate vitit 2019 te kemi mundesi te financojme buxhetin e ketij vitit, te mbyllim pjesen e borxhit te trasheguar dhe te mos krijojme detyrime te reja.** Per te aritur kete rezultat duhet nje pune me pergjegjshmeri nga i gjithë stafi i administrates se Keshillit te Qarkut. Gjithashtu kerkojme pergjegjesi nga te gjithë anetaret e Keshillit te Qarkut per realizimin e kontributit financiar te bashkive per keshillin e qarkut si detyrim ligjor per organet vendore te nivelit te dyte.

Planifikimi i te ardhurave

Per vitin 2019 buxheti total per Keshillin e Qarkut eshte planifikuar ne vlere 105.5 milion leke, duke synuar per te patur nje buxhet sa me real dhe te mbuluar me fonde te realizueshme.

Te ardhurat si burim i financimit te shpenzimeve jane planifikuar mbi bazen e akteve ligjore e nenligjore ne fuqi.

Transferta e pakushtezuar vazhdon te mbetet e ardhura kryesore e buxhetit per organin vendor. **Per vitin 2019 Granti eshte celur ne masen 52.5 milion leke nga 49.5 milion ne vitin 2018, me nje ritje prej 2 milion leke ose 6.1 %.**

Ne planifikimin e te ardhurave jane mbajtur parasysh aktet ligjore ne fuqi si dhe realizimi i tyre ne periudhat e meparshme. **Te ardhurat e veta ne total jane planifikuar ne masen 7.8 milion leke.**

Ne planin e te ardhurave peshen kryesore e kapin te ardhurat nga kontributi financiar I bashkive perberese te keshillit te qarkut. Kjo e ardhur eshte **planifikuar mbeshtetur ne Ligjin 139/2015 “ Per veteqeverisjen vendore” neni 38, pika 3, ku citohet shprehimisht se kuota e anetaresise te bashkive perberese per financimin e buxhetit te qarkut percaktohet me vendim te keshillit bashkiak. Kjo rit pergjegjesine e Bashkive per te planifikuar dhe derdhur ne kohe kete detyrim.** Kjo e ardhur ne vitet e kaluara eshte realizuar ne nivele te ulta duke krijuar deficite te ndjeshme ne buxhetin e keshillit te qarkut dhe kjo per arsye qe jane trajtuar shume here. Nga ana jone ky kontribut eshte planifikuar ne nivelin 6 milion leke nje shifer teper e realizueshme nga te gjitha bashkite pa prekur dhe demtuar buxhetin e tyre.

Te ardhurat nga tarifat e sherbimeve qe ofron Keshilli i Qarkut, jane planifikuar ne nivelet e planit te vitit 2018 ne vlere 1.8 milion leke, pavaresisht se realizimi I pritshem I tyre eshte ne nivele te ulta. Ne kete planifikim eshte mare parasysh ecuria e ketyre te ardhurave ne disa vite, meqenese nuk mund te behen llogaritje te sakat. Ne kete ze futen kryesisht te ardhurat nga tarifat e kadastres dhe urbanistikes. Keshilli I Qarkut nuk ofron me sherbime ne fushen e transportit pasi ato jane competence e vete bashkive.

Gjithashtu per vitin 2018 jane mare ne konsiderate perdorimi I te ardhurave te paperdorura deri tani ne vlere 45 milion leke, te cilat kane qene te planifikuara si kontribut per pjesemarrje ne Programet IPA. Aplikimi I kater projekteve te fituara ka filluar por financimi I aktiviteteve do te vazhdoje ne vitin 2019.

Bashkangjitur eshte pasqyra e tarifave qe aplikon Keshilli I Qarkut per sherbimet qe I ofron komunitetit, te miratuara keto me akte ligjore e nenligjore, si dhe pasqyra e llogaritje analitike te te ardhurave te parashikuara per vitin 2019.

Ne total te ardhurat do te perdoren per financimin e funksioneve te veta te Keshillit te qarkut te miratuara me ligj.

Planifikimi i shpenzimeve

Pjese e rendesishme e planit te buxhetit eshte planifikimi I shpenzimeve . Nga ana e drejtorise se finances planifikimi I shpenzimeve eshte pare me kujdes ne cdo element te saj mbi bazen zbatimit te Ligjit “Per buxhetin e vitit 2019”, te Udhezimeve te Ministrise se Financave per zbatimin e buxhetit si dhe te realizimit te buxhetit per vitin 2018, si dhe mbeshtetur ne miratimin paraprak te dokumentit te Programin Buxhetor Afatmesem 2019-2021. Grupi I punes ka bere parashikimin e buxhetit per vitin 2019 mbi bazen e programeve dhe aktiviteteve te miratuara.

Ne total buxheti per vitin 2019 eshte planifikuar ne vlere 105.5 milion leke, nga te cilat 52.5 milion lek ose 49.8 % e totalit eshte transferta e pakushtezuar dhe 53 milion leke ose 50.2 % e totalit jane te ardhurat e veta dhe ato te trasheguara. Transferta e pakushtezuar vazhdon te mbetet nje burim I rendesishem I financimit te shpenzimeve per Keshillin e Qarkut.014. bashkangjitur materialit eshte tabela analitike e llogaritjes te shpenzimeve te buxhetit.

Planifikimi I shpenzimeve te personalit

Ne zbatim te Ligjit “Per buxhetin e vitit 2019”, te Udhezimeve te Ministrise se Financave dhe Ekonimise “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2019” numuri I punonjesve

te stafit te administrates te keshillit te qarkut do te vazhdoje te jete me 10 punonjes dhe 3 dhe 3 titullare te zgjedhur dhe te emeruar. Ne keto kushte edhe per vitin 2019 do te vazhdohet me te njejten struktyure organizative dhe nivel pagash qe kemi sot. Fondi I pagave eshte llogaritur mbi bazen e ketyre te dhenave. **Ne vlere pagat e sigurimeve shoqerore per vitin 2019 jane 20.2 milion leke ose 19.5 % te totalit te shpenzimeve. Financimi I tyre eshte parashikuar kryesisht me fonde nga transferta e pakushtezuar dhe rreth 1.2 milion leke me te ardhurat e veta.**

Ne buxhetin e vitit 2019 eshte planifikuar edhe financimi I shperblimit per anetaret e kryesise te keshillit te qarkut sipas vendimit perkates ne vlere 1 milion leke.

- **Planifikimi I shpenzimeve operative per administraten e Keshillit te Qarkut**

Planifikimi I shpenzimeve per mallra e sherbime te tjera per vitin 2019 per administraten eshte bere sipas klasifikimit ekonomik per cdo funksion ne vecanti. **Planifikimi I shpenzimeve operative dhe vendimeve gjyqesore per vitin 2019 per funksionimin e administrates se keshillit te qarkut eshte ne nivelin 16.6 milion leke nga te cilat 6.3 milion leke jane shpenzime te trasheguara nga vitet e meparshme dhe detyrime te lindura ne fund te 2018 per shkak te limitit te perdorimit te Cashit per 2 mujorin e fundit.** Financimi I shpenzimeve operative dhe vendimeve gjyqesore do te behet kryesisht me fonde nga transferta e pakushtezuar dhe rreth 4 milion leke me te ardhurat e vete institucionit. Niveli I ketyre shpenzimeve kap rreth 15.73 % te totalit.

Niveli I shpenzimeve eshte planifikuar mbi bazen e normativave te miratuara me akte ligjore per disa zera shpenzimesh si dhe nen nivelin e realizimit te tyre ne keto vite. Kjo eshte nje pergjegjesi per cdo punonjes te institucionit si dhe nje menyre per te akumuluar borxhin e trasheguara. Niveli I planifikuar I shpenzimeve mbulon aktivitetin e administrates se keshillit te qarkut ne permbushje te misionit te tij.

Disa nga zerat qe zene peshe ne shpenzimet operative per administraten e K.Qarkut ne total jane si me poshte:

- Planifikimi I shpenzimeve per karburant eshte llogaritur ne vlere 1.9 milion leke ose rreth 1000 litra ne muaj per automjetet e institucionit ne sherbim te administrates. Konsumi I karburantit eshte llogaritur mbi bazen e normativave te miratuara per vitin 2018.
- Riparimi I automjeteve, blerje goma e bateri si dhe siguracione e taksa te mjeteve eshte llogaritur ne vlere 600 mije leke.
- Blerje kancelari, boje fotokopje e printera eshte llogaritur ne vlere 500 mije leke, si dhe vitin e kaluar.
- Shpenzime per telefoni fikse, internet dhe celulare jane llogaritur ne nivelin 300 mije leke nga te cilat 120 mije leke jane shpenzimet per celulare. Perdorimi I telefonise celulare do te jete deri ne 10 mije leke ne muaj per kryetarin e keshillit te qarkut, por brenda nivelit 2% te shpenzimeve operative (Art.602) sipas akteve ligjore ne fuqi.
- Shpenzimet postare, energji dhe uje jane planifikuar ne vlere 900 mije leke kjo sipas realizimit te tyre ne vite.
- Shpenzime per aktivitete dhe festa jane planifikuar ne masen 1000 mije leke. Kjo vlere do te perdoret per financimin e nje pjese te shpenzimeve per pjesemarjen e Grupit folkloric te qarkut ne Festalet Folklorike Kombetare si dhe peraktivitete e festa rajonale.

- **Planifikimi I Investimeve**

Per vitin 2019 jane planifikuar rreth 21 milion leke investime ose 19.9 % te totalit te buxhetit, ku peshen kryesore me rreth 15 milion leke e zene financimi I investimeve qe po zbatohen ne bashkite e qarkut sipas objekteve te miratuara ne buxhetin e vitit 2018. Aktualisht keto investime jane ne faze zbatimi dhe financimi I tyre do te behet 2019 mbas perfundimit te punimeve dhe marjes ne dorezim. Kete nisme keshilli I qarkut do ta vazhdoje edhe per vitin 2019 me rreth 4.5 milion leke, fond I cili do te rishikohet gjate vitit.

Per vitin 2019 jane planifikuar edhe 1.5 milion leke investime ne infrastrukturen e brendshme, ne permiresim te punes te administrates.

- **Planifikimi I bashkefinancimit ne Projektet e BE**

Per vitin 2019 Keshilli I Qarkut ka miratuar edhe nje fond prej 41 milion leke si pjese e bashkefinancimit te Projekteve te fituara me fonde te Bashkimit Europian.

Ka filluar implementimi I kater projekteve IPA me nje vlere totale rreth 1 miliard euro, ku institucioni jane duhet te financoje 15 % te vleres si kontribut, gjithashtu jane mare masat edhe per financimin e vleres te TVSH, e cila nuk financohet me fonde te BE.

Keshilli I qarkut po vazhdon punen per pjesemarje ne thirje te reja te celuar nga Bashkimi Europian ne bashkepunim me pertnere rajonale e nderkombetare. Kjo do te beje te mundur vazhdimesine e pjesemarjes ne keto Programe, te cilat do te sjellin nje stad te ri te zhvillimit te rajonit.

- **Shpenzime te tjera**

Keshilli I qarkut ne vazhdimesi ka pare mundesine e financimit per sherbime sociale. Per vitin 2019 jane planifikuar disa kontribute financiare si me poshte:

- Ne bashkepunim me Bashkine Korce pjesemarje ne Projektin “ Qendra ditore te moshes se trete “ me 3 milion leke, project I nisur qe ne vitin 2018.
- Kontribut financiar per shoqatat e te verberve qarku Korce me vlere 500 mije leke
- Kontribut financiar per Sherbimin e Kujdesit Paliativ Korce me vlere 400 mije leke.
- Kontribut financiar per Qendren Rezidenciale te Zhvillimit Korce me vlere 150 mije leke.

Keshilli I Qarkut do te kete prioritet zgjerimin e games se financimit ne kete sector.

Keto ishin zerat kryesore te Buxhetit te Keshillit te Qarkut per vitin 2019.

Bashkangjitur ketij material jane pasqyrat permbledhese te te ardhurave dhe shpenzimeve si dhe pasqyra e buxhetit te pergjithshem per vitin 2019.

Korce me 03.12.2018

Liljana PLEQI
Drejtore e Finances

